



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr.759/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtaret: Ferki Xhaferi kryesuese, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkritazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Istogut Dardan Kaliqani nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Istogut, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. Pranohet pjesërisht** si i bazuar apeli Anr.759/2021, paraqitur nga kandidati për Kuvend Komunal Dardan Kaliqani nga radhët e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Istog.

**II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal të Drenasit, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Istog, në Vendvotimin: nr.0615C/01D në fshatin Prigodë në Komunën e Istogut.

**III. Refuzohet si e pabazuar** pjesa tjetër e apelit për vendvotimet QV 0601C Istog, QV 0602C Banja e Pejës, QV 0604C Gurrakoc, QV 0605C Zallq, QV 0606C Vrellë, QV 0608C Rakosh, QV 0609C Dubravë, QV 0610C Muzhevinë, QV0612C Kovragë, QV 0614C Veriq, QV 0617C Trubohoc, QV 0619C Saradran, QV 0620C Cerrcë, QV 0621C Kalijan, QV 0622C Llukac i Bregut, QV 0623C Cerkolez, VV 0621C/01R Kalijan, VV 0609C/01R Dubravë.

**IV. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë e Vendvotimit si në pikën - II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

**A r s y e t i m**

PZAP-i, ka pranuar apelin Anr.759/2021 me datën 03.11.2021, nga kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal të Drenasit, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Drenas me të cilat pretendon se ka mungesë të votave në rezultatet

përfundimtare të shpallura nga KQZ-ja për shkak se në QV 0615C vendvotimi 0615C/01D në fshatin Prigodë, shoku i tij Jetmir Gashi deklaroi se e ka votuar të njëjtin së bashku me nënën e tij, ndërsa ka marrë 0 vota në atë vendvotim. Gjithashtu përgjatë bisedave me njerëz të ndryshëm i kanë thënë se e kanë votuar, andaj ka kërkuar që të rinumërohen të gjitha votat në Qendrat e Votimit si vijon: QV 0601C Istog, QV 0602C Banja e Pejës, QV 0604C Gurrakoc, QV 0605C Zallq, QV 0606C Vrellë, QV 0608C Rakosh, QV 0609C Dubravë, QV 0610C Muzhevinë, QV0612C Kovragë, QV 0614C Veriq, QV 0617C Trubohoc, QV 0619C Saradran, QV 0620C Cerrcë, QV 0621C Kaliqan, QV 0622C Llukac i Bregut, QV 0623C Cerkoz, VV 0621C/01R Kaliqan, VV 0609C/01R Dubravë dhe VV 0615C/01D në Prigodë, të gjitha në Komunën e Istogut.

Apelit i ka bashkangjitur dëshmi si deklaratën e dëshmitarit Jetmir Gashi si dhe Formularët e Rezultateve të Kandidatëve për vendvotimet e apeluara.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

#### **Apeli është pjesërisht i bazuar**

Nga shkresat e lëndës, rezulton se Dardan Kaliqani, kandidat për Kuvend Komunal nga radhët e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Istog brenda afatit ligjor, ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në QV 0601C Istog, QV 0602C Banja e Pejës, QV 0604C Gurrakoc, QV 0605C Zallq, QV 0606C Vrellë, QV 0608C Rakosh, QV 0609C Dubravë, QV 0610C Muzhevinë, QV0612C Kovragë, QV 0614C Veriq, QV 0617C Trubohoc, QV 0619C Saradran, QV 0620C Cerrcë, QV 0621C Kaliqan, QV 0622C Llukac i Bregut, QV 0623C Cerkoz, VV 0621C/01R Kaliqan, VV 0609C/01R Dubravë dhe VV 0615C/01D në fshatin Prigodë, të gjitha në Komunën e Istogut.

Paneli vlerëson se apeli është pjesërisht i bazuar vetëm sa i përket vendvotimit si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi, nga se rezulton se në Formularin e Rezultateve të Kandidatëve në vendvotimin 0615C/01D kandidatit për kuvend komunal Dardan Kaliqani ka 0 vota, ndërsa sipas deklaratës së votuesit Jetmir Gashi të bashkangjitur në apel i cili thekson se e ka votuar të njëjtin së bashku me nënën e tij, këto vota nuk rezultojnë të jenë në rezultatin përfundimtar të shpallur nga KQZ-ja, prandaj Paneli konstaton se ka mospërputhje të rezultatit me deklaratën e votuesit, andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së e urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimit e lartcekura si në pikën II të dispozitivit.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencja, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitivit se

lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Ndërsa sa i përket pikës III të dispozitivit Paneli, vlerëson se parashtuesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Anr.759/2021 më datën 06.11.2021.**

**Kryesuesja e Panelit**

**Ferki Xhaferi**

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimet të këtij vendimi.

